



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

# UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 8

## LevizAlbania

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

ZBATUAR NGA



FONDACIONI SHOQËRIA  
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



PARTNERËT SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM





**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

Ky udhëzues shërben për të ofruar informacionet e nevojshme për të gjithë të interesuarit për të aplikuar me koncept-ide në Thirrjen për Aplikime Nr. 8, të LevizAlbania. Udhëzuesi shpjegon hapat, procedurat, dokumentacionin e kërkuar, rregullat dhe afatet e të gjithë procesit të Thirrjes, që nga hapja e saj, fazat pasardhëse dhe deri në përfundimin e saj.

Ky udhëzues është i rëndësishëm për të gjitha ato Organizata Jofitimprurëse, Grupe informale dhe Individë që janë të interesuar të aplikojnë pranë LevizAlbania. Për çdo informacion apo paqartësi mund të na shkruani në [info@levizalbania.al](mailto:info@levizalbania.al) ose na kontaktoni në numrin e telefonit +355 44 500 153.

## 1. Kush mund të aplikojë?

LevizAlbania mbështet përmes instrumentit të grantdhënies, Organizatat Jo Fitimprurëse (OJF)<sup>1</sup>, grupet informale<sup>2</sup> dhe individët.

Organizatat e shoqërisë civile (OJF), organizatat me bazë në komunitet, organizatat e reja, grupet e të rinjve dhe të grave, individët apo grupimet e tyre, lëvizjet qytetare, grupe të ndryshme interesi, etj., në zona urbane e rurale, janë të gjithë të ftuar dhe kanë mundësinë të aplikojnë në këtë thirrje.

**E rëndësishme:** Nëpërmjet Thirrjes për Aplikime Nr. 8, LevizAlbania synon forcimin e masës kritike qytetare dhe shtrirjen e mbështetjes me aktorë të rinj. Në këtë Thirrje do të **MBËSHTETEN** organizata të shoqërisë civile (OJF) të cilat nuk kanë përfituar një grant më parë me LevizAlbania.

Në seksionin 'Rregulla të Përgjithshme për Aplikimin dhe Informacion Shtesë' janë përcaktuar shprehimisht rastet e mospërputhshmërisë për të aplikuar në këtë thirrje.

<sup>1</sup>OJF-të janë ato organizata që janë regjistruar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar, (ligji për regjistrimin e OJF Nr.8788, datë 7.5.2001) dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Shqipërisë.

<sup>2</sup>Grup informal është një grupim qytetaresh aktivë që ndajnë të njëjtat vlera dhe parime, dhe që veprojnë sëbashku për të adresuar çështje e probleme social ekonomike në komunitetin dhe/ose fushën e tyre. Grupi informal nuk është i regjistruar në gjykatë dhe qëllimi i veprimtarisë së tij nuk është fitimprurës.



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

## 2. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikimeve:

**Thirrja është e hapur nga data 21 Maj 2021 deri në datën 20 Qershor 2021 (ora 23:59).**

Aplikimi bëhet **VETËM** në formatin **ONLINE**. Për të aplikuar ONLINE duhet të vizitoni faqen zyrtare [www.levizalbania.al](http://www.levizalbania.al) dhe të klikoni në rubrikën Thirrja për Aplikime Nr. 8.

Formati i aplikimit ONLINE është i disponueshem në fund të tekstit të Thirrjes Nr. 8, të publikuar në këtë rubrikë.

### **Instruksione të rëndësishme për formatin e aplikimit ONLINE:**

- Bëni kujdes në përzgjedhjen e një prej Drejtimeve të Thirrjes;
- Në përzgjedhjen e zonës së zbatimit, për më shumë se 1 (një) bashki duhet të mbani të shtypur në tastierën e kompjuterit butonin CTRL dhe më pas përmes MOUSE-it të përzgjidhni bashkitë e planifikuara. Në rast se idea juaj ka një shtrirje kombëtare, ky opsion ndodhet në krye të kategorisë “zona e zbatimit”. Në aplikimet përmes telefonit celular mjafton të klikoni njëherë mbi çdo bashki për përzgjedhjen e shumëfishtë;
- Në vendosjen e vlerës financiare të kërkuar për mbështetjen e koncept-idesë, në këtë fazë të aplikimit duhet vendosur vetëm një vlerë numerike, shembull: 25500 (pa presje dhjetore, pa pika, pa viza në pjesën e poshtme të numrave apo në mesin e tyre);
- Respektoni numrin e karaktereve për secilën fushë që duhet të plotësoni. Numri ndryshon për secilën prej fushave boshe sipas specifikimeve përkatëse, dhe në rast të tejkalimit të tij, sistemi nuk do t’ju lejojë të vijoni shkrimin;
- Aplikanti QJE, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit vendimin më të fundit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi organizatën, në formatin JPG (fotografi) ose PDF;
- Aplikanti GRUP INFORMAL, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit një CV të personit që drejton/koordinon Grupin, si dhe një CV të vetë Grupit informal (duke përfshirë aktivitete të mëparshme të grupit, si dhe emrat e anëtarëve të grupit), në formatin PDF ose Microsoft Word;
- Aplikanti INDIVID, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit CV-në përkatëse, në formatin PDF ose Microsoft Word;
- **KUJDES:** Të gjitha fushat për tu plotësuar gjatë aplikimit janë të shënuara me shenjën\* (Asterix) dhe janë të detyrueshme për tu plotësuar. Në rast të mos plotësimit të këtyre fushave nuk do të lejoheni të përfundoni APLIKIMIN tuaj;
- Në përfundim mjafton të klikoni “APLIKO” dhe keni përfunduar;
- Pas dërgimit të aplikimit do t’ju mbërrijë në adresën e postës elektronike të vendosur në aplikim, mesazhi nga serveri i LevizAlbania: “Faleminderit që Aplikuat” dhe bashkëlidhur do të jetë një kopje e aplikimit. Vetëm marrja e emailit konfirmon se aplikimi juaj ka mbërritur pranë LevizAlbania dhe ka qenë i suksesshëm.



### 3. Drejtimet e Thirrjes

*Kujdes: Drejtimet e Thirrjes përfaqësojnë objektivat që LevizAlbania synon të arrijë përmes ideve/nismave në kuadër të mbështetjes së aktorëve të shoqërisë civile, grupimeve informale dhe individëve.*

**LevizAlbania** synon të forcojë demokracinë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë për një qeverisje cilësore. LevizAlbania është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare: "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" dhe "Co-PLAN".

**LevizAlbania**, nëpërmjet Thirrjes për Aplikime Nr. 8, mbështet aksionin qytetar i cili kultivon vetëdijen dhe aftësinë për nisma konkrete në: mbrojtjen e mjedisit dhe reagimin ndaj efekteve negative të ndryshimeve klimatike; monitorimin e proceseve vendimmarrëse; veprimtari informimi dhe edukimi mbi transparencën dhe cilësinë e shërbimeve vendore; si dhe angazhimin efektiv të rinisë në nivel vendor.

**LevizAlbania** fton organizatat Jo Fitimprurëse (OJF), grupet informale dhe individët të aplikojnë me koncept-ide në Thirrjen për Aplikime Nr. 8 me qëllim: **përmirësimin e demokracisë vendore dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve në nivel vendor.**

Të interesuarit ftohen të dërgojnë **KONCEPT-IDE** bazuar në drejtimet e mëposhtme:

**Drejtimi I: Qytetari aktive – Nxitja e angazhimit qytetar mbi çështje me interes për komunitetin në nivel vendor (fokusuar në mbrojtjen e mjedisit, efikasitetin dhe energjinë dhe/ose përdorimin e energjisë së rinovueshme për të përballuar efektet negative të ndryshimit të klimës)**

Nëpërmjet këtij drejtimi LevizAlbania synon mbrojtjen e mjedisit, efikasitetin energjitik dhe përballjen me efektet negative të ndryshimeve klimatike nëpërmjet aktivizimit qytetar në nivel vendor. Specifikisht, ky drejtim synon të mundësojë krijimin e një marrëdhënie të re të qytetarëve me ambientin si parakusht për vendimmarrje gjithëpërfshirëse, parandalimin e degradimit mjedisor dhe përballjen me efektet negative të ndryshimeve klimatike. Ky drejtim mirëpret ndërhyrje të cilat informojnë, edukojnë dhe mundësojnë monitorim të qeverisjes vendore, shfrytëzimit të mjedisit, pronës publike, etj. të cilat shoqërohen/finalizohen me veprime konkrete.

*Rezultatet e pritshme nën këtë drejtim duhet të sjellin veprime konkrete nga komuniteti dhe reagime konkrete nga njësitë e qeverisjes vendore në përgjigje të propozimeve/kërkesave nga komuniteti në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe/ose përballjen me efektet negative të ndryshimeve klimatike.*



**LEVIZ**Albania  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

*Veprimtari/Idetë të sugjeruara për realizimin e këtij drejtimi janë (por jo të kufizuara në sa më poshtë):*

- Edukimi mjedisor i orientuar drejt fuqizimit të komuniteteve lokale për të marrë pjesë aktivisht në mbrojtjen e mjedisit dhe vendimmarrjen vendore;
- Edukim qytetar me qëllim fuqizimin e komuniteteve lokale për çështje që lidhen me efikasitetin dhe energjinë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme;
- Ndërgjegjësimi i komunitetit në lidhje me riciklimin dhe gjetja e mënyrave inovative për të luftuar ndotjen dhe mundësuar një ambient natyror të shëndetshëm;
- Mbrojtja e të drejtave mjedisore që mund të orientohen drejt sigurimit të mbështetjes, përfshirë mbështetjen ligjore veçanërisht për grupet e rrezikuara/marxhinalizuara të shoqërisë, të nënshtruara ndaj rreziqeve të shkaktuara nga degradimi mjedisor dhe ndryshimet klimatike.

**Drejtimi 2: Aksione konkrete – Shfrytëzimi i mjeteve ligjore dhe angazhimi i qytetarëve në “monitorim dhe veprim” me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve vendore.**

Mekanizmat ligjorë dhe instrumentat institucionalë për informimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin me qytetarët ekzistojnë, por jetëzimi dhe përdorimi efektiv i tyre kërkon ende punë dhe mbështetje aktive. Nga njëra anë, institucioneve të qeverisjes vendore i mungon vullneti për t'i përdor plotësisht këto instrumente, nga ana tjetër qytetarët kanë mungesë të njohurive dhe aftësive për t'u aktivizuar dhe monitoruar apo nxitur pushtetin vendor. Kësisoj ky drejtim mirëpret ndërhyrje të cilat nxisin aktivizimin qytetar nëpërmjet informimit dhe edukimit si dhe duke mundësuar ndërmarrjen e monitorimeve procedurale të veprimtarisë së qeverisjes vendore të cilat duhet të pasohen nga nisma konkrete.

Mekanizmat ligjorë dhe instrumentat institucionalë për informimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin me qytetarët ekzistojnë, por jetëzimi dhe përdorimi efektiv i tyre kërkon ende punë dhe mbështetje aktive. Nga njëra anë, institucioneve të qeverisjes vendore i mungon vullneti për t'i përdor plotësisht këto instrumente, nga ana tjetër qytetarët kanë mungesë të njohurive dhe aftësive për t'u aktivizuar dhe monitoruar apo nxitur pushtetin vendor. Kësisoj ky drejtim mirëpret ndërhyrje të cilat nxisin aktivizimin qytetar nëpërmjet informimit dhe edukimit si dhe duke mundësuar ndërmarrjen e monitorimeve procedurale të veprimtarisë së qeverisjes vendore të cilat duhet të pasohen nga nisma konkrete.

**E rëndësishme:** Elementi i monitorimit nën këtë drejtim synon të sjellë një qasje inovative ku përveç identifikimit të problematikave, sukseseve, dështimeve dhe rekomandimeve - njohuritë e grumbulluara përdoren për të mundësuar ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga komuniteti dhe reagimeve konkrete nga njësitë e qeverisjes vendore për të rritur cilësinë dhe zgjeruar gamën e shërbimeve publike. Pra, drejtimi 2 synon mundësimin e 'monitorimit dhe veprimit' që potencion aksione konkrete të bazuara në angazhimin e qytetarëve.



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

*Veprimtari/Idetë të sugjeruara për realizimin e këtij drejtimi janë (por jo të kufizuara në sa më poshtë):*

- Fuqizimi i aftësive të komuniteteve dhe/ose grupeve qytetare për të ushtruar të drejtat e tyre përballë NJQV-ve (p.sh. përmes ndërgjegjësimit, informimit, edukimit qytetar, fuqizimit ligjor, rrjetëzimit, mbështetjes për veprime konkrete, etj.);
- Nxitje e përfshirjes aktive dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimarrëse vendore (p.sh. mbledhjet e Këshillave Bashkiak për sa i përket organizimit dhe funksionimit, këshillimet publike, përpunimit dhe trajtimit të ankesave, propozimeve, kërkesave, peticioneve dhe nismave të qytetarëve, etj.);
- Rritje e presionit qytetar për transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me: shpenzimet publike të NJQV-ve, prokurimet vendore, ekzekutimin e kontratave publike me operatorët privatë që ofrojnë shërbime; denoncimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit, etj.

### **Drejtimi 3: Qytetari e angazhuar – Përdorimi i instrumenteve të demokracisë pjesëmarrëse me qëllim zgjidhjen e problemeve komunitare.**

Ky drejtim synon potencimin e qytetarëve aktivë në komunitete të vogla (p.sh. lagje, fshat, etj.) që të mobilizojnë grupe ose rrjete informale, për t'i kërkuar qeverisjes vendore adresimin dhe zgjidhjen e problemeve konkrete në komunitetet e tyre. Ky drejtim ofron mbështetje për aksione qytetare në komunitete të cilat ndajnë një shqetësim apo problematikë dhe kanë nevojë për mbështetje e mentorim për të arritur rezultate konkrete. Këto rezultate duhet të arrihen duke përdorur instrumente të demokracisë pjesëmarrëse dhe mekanizmave ligjorë në dispozicion (konsultime, iniciativa qytetare, peticione, etj.) për të marrë një zgjidhje nga strukturat e pushtetit vendor.

*Grantet nën këtë drejtim ofrojnë një financim bazë dhe do të shoqërohen me mentorim dhe mbështetje teknike nga LA gjatë zbatimit të projektit.*

### **ANALIZA E PËRGJITHSHME E KONTEKSTIT**

LevizAlbania (LA) nga 2015 ka shpallur **7 Thirrje për Aplikime**, nëpërmjet të cilave organizatat e shoqërisë civile, grupet informale dhe individët janë mbështetur në zbatimin e nismave konkrete dhe inovative me synim përmirësimin e demokracisë vendore dhe rritjen e angazhimit qytetar. Përgjatë këtyre viteve janë vlerësuar **2,100 aplikime**, nga të cilat janë financuar **226 projekte**, (në fazën e parë të LA janë mbuluar 61 bashki, ndërsa në fazën e dytë 47 bashki). LA, ndryshe nga projektet e tjera të ngjashme – mbështet në mënyrë aktive dhe të drejtpërdrejtë individët dhe grupet informale. **720 individë dhe grupe informale** kanë aplikuar me ide konkrete për përmirësimin e demokracisë në



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

komunitet e tyre. Ky interesim tregon se gatishmëria për qytetari aktive është e pranishme në komunitete anë e kënd Shqipërisë. Përveç besimit tek LA dhe gatishmërisë për të marrë përsipër fatet e komuniteteve të tyre, analiza e aplikimeve nxjerr në pah disa tendenca mbi problematikat dhe nevojat për mbështetje nga këndvështrimi i vetë komuniteteve. Specifikisht, organizatat e shoqërisë civile, grupet informale dhe individët kanë kërkuar mbështetjen e LA kryesisht në fushat e mëposhtme:

**Mjedisi** - reflektuar në çështje që kanë të bëjnë me administrimin e burimeve natyrore, menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve, degradimin mjedisor, si dhe përfshirjen e qytetarëve në vendime që prekin ambientin ku ata jetojnë – përbën **26% të aplikimeve**.

**Përmirësimi i shërbimeve** – reflektuar në çështje që lidhen me informimin, monitorimin dhe advokimin për ofrimin e shërbimeve publike nga pushteti vendor - përbën **22% të aplikimeve**.

**Rinia** - reflektuar në çështje që lidhen me fuqizimin, përfshirjen në dhe aktivizimin për përmirësimin e komuniteteve ku ato jetojnë, si dhe aftësimin për sfidat e të ardhmes – përbën **17% të aplikimeve**.

Nisur nga sa më sipër, LA organizoi grupe tematike të fokusuara si dhe hulumtime dokumentash dhe raportesh për të identifikuar nevojat për ndërhyrje.

#### Sfidat dhe nevojat në sektorin e mjedisit:

Shqipëria, një vend me shkallë të lartë të efekteve negative nga ndryshimet klimatike<sup>3</sup>, mbetet ende në fazën e hershme të marrjes së masave parandaluese dhe mbrojtëse.

Ndikimet e shumëanshme të degradimit mjedisor dhe ndryshimeve klimatike po ndihen në komunitete të ndryshme në Shqipëri të cilat përballen me përmblytje ciklike, erozion, thatësira, etj. Zinxhiri i efekteve negative të degradimit mjedisor fillon në zonat rurale dhe përfundon në zonat urbane duke prekur të gjithë shoqërinë. Po aq e rëndësishme, rritja e eficiencës së energjisë është pashmangshmërisht e lidhur edhe me sektorë të tjerë siç është mbrojtja e mjedisit dhe shfrytëzimi racional i burimeve natyrore. Studime të ndryshme cilësojnë faktin se kursimi i energjisë si dhe shfrytëzimi sa më eficient i saj, ndikon në uljen e konsumit specifik, në furnizim të rregullt dhe cilësor të konsumatorëve, uljen e kostos dhe shërbimeve vendore, përmirësimin e ndjeshëm të bilancit energjetik dhe mbrojtjen e mjedisit.

<sup>3</sup> [https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Albania%20NC3\\_13%20October%202016.pdf](https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Albania%20NC3_13%20October%202016.pdf) “Sipas Ministrisë së Mjedisit Shqipëria preket nga ndryshimet klimatike si rrjedhojë e pozitës së saj gjeografike. Pasojat përfshijnë thatësira e përmblytje të përsëritura, erozion, ndryshime në stinët e bujqësisë, humbja e biodiversitetit, zhvillimi i sëmundjeve infektive, etj”





**LEVIZ**Albania  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

Duke qenë se degradimi mjedisor dhe ndryshimet klimatike janë kryesisht të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, marrja e masave për ndryshimin e mendësisë, strukturës së incentivave, kursimin e energjisë ose përdorimin e energjisë së rinovueshme, që kushtëzojnë keto veprimtari në lidhje me mjedisin, përbën një instrument efektiv parandalues.

Ndëryhyrja në nivel vendor ofron mundësi për të rritur angazhimin qytetar, për të mbrojtur mjedisin si një e mirë e përbashkët dhe për të rritur përgjegjësinë individuale edhe të bashkësisë. Njëkohësisht vetëqeverisja vendore mund të luaj një rol pozitiv në ndërtimin e proceseve konsultuese dhe vendimmarrjeve përfshirëse mbi administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve mjedisore.

Të gjitha shërbimet që përcaktojnë funksionet e bashkive në fushën e mjedisit sipas ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, përbëjnë grupin e shërbimeve mjedisore si: shërbimet për mbrojtjen e mjedisit; administrimi i fondit pyjor dhe kullor publik; mbrojtja e natyrës e biodiversitetit dhe shërbime të lidhura me mjedisin. Është e rëndësishme të theksohet që përveç detyrimit pozitiv që i mvishet organeve shtetërore, mbrojtja e mjedisit dhe përmbushja e detyrimeve ndaj natyrës duhet të jetë përgjegjësi e të gjithëve, në të gjitha nivelet e shoqërisë. Pra, duhet të përfshijë të gjitha grupet shoqërore. Në këtë rast, shoqëria civile është një faktor i rëndësishëm i cili mund të monitorojë dhe mbajë qeverinë përpara përgjegjësisë.

Duke qenë se një sërë kompetencash mbi mjedisin si administrimi i fondit pyjor dhe kullor publik, mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit dhe zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese mbi mjedisin ushtrohen tërësisht nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) ose në bashkërendim me qeverinë qendrore, është koha për të ndërtuar një marrëdhënie të NJVV-ve dhe qytetarëve me mjedisin bazuar mbi bashkë-pronësi dhe bashkë-përgjegjësi.

Kjo përjasje bazohet në faktin që se përveç detyrimit pozitiv që i vishet organeve shtetërore – qendrore dhe vendore – mbrojtja e mjedisit dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore përbën përgjegjësi të të gjithëve dhe **duhet të përfshijë të gjitha grupet shoqërore**. Për këtë arsye LA do të mbështesë shoqërinë civile dhe aktorë të ndryshëm vendorë të saj për të ndërmarrë ndërhyrje të cilat mundësojnë dhe potencojnë një marrëdhënie të re me ambientin në nivel vendor për të parandaluar degradimin mjedisor dhe për t’u përballur me efektet negative të ndryshimeve klimatike.

#### Sfidat dhe nevojat në qeverisjen vendore:

Siç reflektohet nga sasia dhe gama e tematikave të aplikimeve pranë LA, qeverisja vendore ka ende shumë punë për të bërë në përmbushjen e detyrimeve, pritshmërive dhe nevojave të qytetarëve si dhe përfshirjen e të rinjve në komunitetet ku ato jetojnë.





Gjatë viteve të fundit është përmirësuar kuadri ligjor<sup>4</sup> që sanksionon kornizën institucionale dhe mundëson përfshirjen qytetare në vendimmarrje<sup>5</sup>. Në këtë kuadër ka patur një sërë ndryshimesh thelbësore në kompetencat e organeve vendimmarrëse të NJVV-ve<sup>6</sup> në lidhje me pjesëmarrjen qytetare. Megjithatë, jetëzimi i këtyre mekanizmave është ende i pjesshëm pasi reforma administrative mbetet e papërfunduar plotësisht. Specifikisht, pavarësisht përpjekjeve, ekzistojnë ende boshllëqe në planifikimin vendor, caktimin e detyrave funksionale, plotësimin e kornizës së decentralizimit fiskal, rritjen e kapaciteteve të administratës vendore si dhe përballimin e sfidave për një zhvillim të qëndrueshëm.

Shumë nga çështjet e mësipërme, përveç burimeve të kufizuara, rrjedhin edhe nga papërshtatshmëria dhe pamjaftueshmëria e komunikimit, informimit dhe përfshirjes së qytetarëve dhe sidomos të rinjve në të gjitha hallkat dhe fazat e vendimmarrjes. Mungesa e komunikimit dhe përfshirjes së strukturuar kanë prodhuar mosnjohje dhe kanë krijuar mosbesim të cilat janë reflektuar në qytetari dhe rini pasive. Kombinimi i burimeve të pamjaftueshme me përfshirjen e papërshtatshme dhe qytetarinë pasive përbën një rrezik për funksionimin e strukturor për demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në nivel vendor.

Këto problematika u shtuan edhe më tepër vitin e fundit pasi pandemia COVID-19<sup>7</sup> preku të gjithë zinxhirin e funksionimit të ekonomisë dhe shoqërisë në botë dhe Shqipëri. Si rrjedhojë, institucionet publike në nivel qendror dhe vendor, sektori privat, OShC-të, etj., u përballën me vështirësi dhe pasiguri të cilat ndikuan edhe në pjesëmarrjen dhe monitorimin qytetar në qeverisje<sup>8</sup>.

<sup>4</sup> Ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”; Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

<sup>5</sup> Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” mundëson mekanizma nëpërmjet të cilëve qytetarët mund të përfshihen, informohen, dhe këshillohen në vendimmarrjen e qeverisjes vendore. Mundësi përfshirjeje ofrohen edhe nga: Ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”; Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

<sup>6</sup> Çdo qytetar ose grup ka të drejtë të adresojë kërkesa, ankesa ose vërejtje për çështje që lidhen me funksionet, përgjegjësitë dhe shërbimet brenda kompetencave të Këshillit Bashkiak dhe Ekzekutivit të bashkisë. Këshilli Bashkiak është i detyruar të garantojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes, përmes seancave të konsultimit me komunitetin ose pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në hartimin e dokumenteve të politikave dhe projekteve të Bashkisë. Çdo person ose organizatë që ka interes në punët e bashkisë dhe kushdo që jeton, punon ose studion në territorin e Bashkisë ka të drejtë të paraqesë një kërkesë në Këshillin Bashkiak, për çdo çështje që lidhet me funksionet dhe përgjegjësitë e bashkisë. Takimet e Këshillit janë të hapura për publikun dhe të gjithë qytetarët lejohen të marrin pjesë lirisht në Takimet e Këshillit dhe Komiteteve të Këshillit.

<sup>7</sup> Disa veprime janë ndërmarrë për përshtatjen e qeverisjes vendore ndaj COVID-19. Për shembull, shumica e mbledhjeve të Këshillave Bashkiak organizohen online. Nga ana e tjetër, digjitalizimi ka stimuluar format e reja të aktivizmit dhe advokimit të mbështetur nga LA si peticionet elektronike (platforma QytetarIN) apo vendosja e përparësive në buxhetet vendore në 61 bashki (platforma buxhetim.al).

<sup>8</sup> Një nga efektet negative të COVID-19 në funksionimin e qeverisjes vendore është vendimmarrja e pa këshilluar me shoqërinë civile, biznesin, etj. Për shembull, vendimet e bashkive për lehtësirat fiskale të bizneseve vendore ndikuan në të ardhurat e tyre dhe sollën zvogëlimin e shërbimeve të planifikuara dhe pezullimin e investimeve për strehimin social, një shërbim i domosdoshëm për shumë familje në nevojë.



Bazuar në sa më sipër, LA do të mbështesë shoqërinë civile dhe aktorë të ndryshëm vendorë për të ndërmarrë ndërhyrje të cilat mundësojnë dhe fuqizojnë përfshirjen aktive të qytetarëve dhe rinisë në vetë-qeverisjen e tyre në nivel vendor nëpërmjet monitorimit të bazuar në veprim.

Kjo përfshirje, ndër të tjera, mund të arrihet duke nxitur aktivizmin qytetar nëpërmjet informimit dhe edukimit si dhe duke mundësuar ndërmarrjen e monitorimit të procedurave e veprimtarisë së qeverisjes vendore të cilat duhet të pasohen nga nisma konkrete. Së bashku, këto nisma/veprimtari kanë potencialin për të rritur aktivizmin qytetar, shtuar njohuritë e qytetarëve për vetëqeverisjen vendore, rritur presionin për qeverisje të përgjegjshme, shtuar kanalet e përfshirjes së të rinjve dhe në tërësi zvogëluar hendekun e bashkëpunimit midis qytetarëve dhe NJQV.

#### 4. **Kushtet për aplikim, madhësia e granteve dhe afati i zbatimit**

- Drejtimit 1 dhe 2 janë të hapura për të gjithë OJF-të e regjistruara sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;
- Në këtë Thirrje do të mbështeten **organizata të shoqërisë civile (OJF)** të cilat nuk kanë përfiturar një grant më parë me LevizAlbania.
- Grupet Informale mund të aplikojnë në Drejtimit 1, 2 dhe 3;
- Individët mund të aplikojnë vetëm në Drejtimitin 3;
- OJF-të që aplikojnë Drejtimitin 1 dhe 2 planifikojnë të zbatojnë projekte jashtë zonës së qarkut ku operojnë duhet të kenë partneritet me OJF-të lokale. Partneri lokal duhet të ketë rolin e liderit në aplikim.
- Grupet Informale dhe Individët mund të aplikojnë me konceptide që propozojnë ndërhyrje vetëm në Bashkinë ku banojnë;
- Grantet për OJF do të variojnë nga **10,000 CHF** deri në **60,000 CHF**;
- Kufiri maksimal i granteve për Grupet Informale është **10,000 CHF**;
- Kufiri maksimal i granteve për Individë është **7,000 CHF**;
- Afati maksimal i zbatimit të projektit është **12 muaj**.

#### 5. **Kriteret e Vlerësimit**

**Kriteret kryesore për vlerësimin e koncept-ideve janë si më poshtë vijon:**

- Përputhja e konceptidesë me drejtimet/objektivat e thirrjes;
- Kuptueshmëri e mirëformular e problemit të identifikuar dhe adresim i duhur i tij (mungesa e identifikimit të qartë të problemit, përjashton koncept-idenë nga vlerësimi i mëtejshëm);
- Qartësi dhe lidhje logjike në përcaktimin e qëllimit kryesor dhe objektivave specifike;



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

- Strukturimi dhe planifikimi i aktiviteteve, si dhe lidhja logjike e tyre me objektivat dhe rezultatet e pritshme;
- Vlera e shtuar dhe risia që sjell ndërhyrja e propozuar.

**E rëndësishme:** LevizAlbania gjatë fazës së dytë ka financuar ndërhyrje në 48 bashki. Për të siguruar një shtrirje gjeografike më të gjerë me ndërhyrje që shtrihen në të gjithë territorin e vendit do të konsiderohen me vlerë të shtuar koncept-idetë që targetojnë bashki nga lista që vijon: Libohovë; Gjirokastrë; Krujë; Delvinë; Shijak; Dropull; Këlcyrë; Memaliaj; Ura Vajurore; Selenicë; Konispol dhe Finiq.

## 6. Rregulla të Përgjithshme për Aplikimin dhe Informacion Shtesë

- OJF-të, grupet informale dhe individët janë të lejuar të aplikojnë vetëm me një projekt-ide;
- Ndërhyrjet e propozuara në një Bashki (ose komunitet) të caktuar propozohen nga individë/grupe informale/organizata që banojnë/operojnë në të njëjtin Qark.
- Organizatat lokale duhet të kenë rolin e liderit në aplikim, në zbatimin e ndërhyrjes dhe në administrimin e buxhetit, e cila do të pasqyrohet edhe në kontratën e grantit.
- Grantmarrës aktualë të LevizAlbania të cilët janë duke zbatuar një projekt grant të financuar nga LA gjatë periudhës që thirrja qëndron e hapur nuk mund të pranohen të aplikojnë.
- Nuk mund të pranohen aplikime/koncept-ide nga shoqatat e njëjësive vendore.
- Nuk mund të pranohen aplikime/koncept-ide nga organizata të shoqërisë civile që kanë të përfshirë në strukturat e tyre, apo në grupet e punës të propozuar:
  - persona që janë në një konflikt interesi, në lidhje me statusin e tyre profesional ose personal;
  - persona që janë të punësuar në projekte të Organizatave/Donatorëve Ndërkombëtarë;
  - persona që janë të punësuar në administratën publike apo që janë pjesë e organeve të zgjedhura qendrore apo vendore;
- Rregulli i mësipërm vlen edhe për aplikuesit individë apo grupe informale, të cilët duhet gjithashtu të deklarojnë se nuk janë në një nga kushtet e përmendura më sipër.
- OJF-të duhet të paraqesin vendimin më të fundit të marrë nga Gjykata, lidhur me statusin e tyre;
- Grupet informale duhet të dërgojnë CV-të grupit (pasqyrim i aktiviteteve të kaluara të grupit si dhe emrat e anëtarëve kryesorë të tij), si dhe CV-në e koordinatorit apo përfaqësuesit të grupit për këtë projekt propozim;
- Individët që aplikojnë për Drejtimin 3 duhet të dërgojnë CV e tyre (vetëm CV-në e individit aplikant);
- LevizAlbania nuk njeh si shpenzim të projektit Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

**E rëndësishme:** Nëpërmjet Thirrjes për Aplikime Nr. 8, LevizAlbania synon forcimin e masës kritike qytetare dhe shtrirjen e mbështetjes me aktorë të rinj. Në këtë Thirrje do të **MBËSHTETEN** organizata të shoqërisë civile (OJF) të cilat nuk kanë përfutur një grant më parë me LevizAlbania.

**LevizAlbania kërkon nga aplikantët që në hartimin e koncept-ideve të tyre:**

- të përfshijnë **perspektivën gjinore;**
- të përfshijnë **grupet e targetuara:** gratë dhe vajzat, rinia, grupet e marginalizuara;
- të **bashkëpunojnë me gazetarë dhe media** për të advokuar apo për të shpërndarë në publik mesazhet kryesore;
- të **stimulojnë vullnetarizmin;**
- të konsiderojnë në koncept-ide **bashkepunime** me organizata të tjera, individë dhe/ose grupe informale **me qëllim krijimin e koalicioneve të mundëshme.**


**LevizAlbania NUK mbështet projekte/aktivitete që synojnë:**

- Ofrimin e shërbimeve sociale;
- Realizimin e kompetencave/detyrave të pushtetit vendor;
- Trajnime të administratës vendore;
- Vetëm dhe kryesisht zhvillimin e tryezave të rrumbullakta / seminareve që nuk sjellin rezultat konkret e të prekshëm për qytetarët;

## **7. Hapat e Thirrjes për Aplikime Nr. 8**

Mekanizmi i përzgjedhjes së projekteve më të mira të Thirrjes për Aplikime Nr. 8 të LevizAlbania kalon në tre faza që sigurojnë transparencë, përfshirjen e grupeve të interesit dhe cilësi të lartë të aplikimeve, të cilat duhet të jenë në përputhje me drejtimitet e thirrjes.

**MEKANIZMI I PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE**



• **Informimi dhe Komunikimi për Thirrjen për Aplikime 8**

Gjatë periudhës kur Thirrja për Aplikime Nr. 8 do të qëndrojë e hapur, LevizAlbania do të organizojë 6 (gjashtë) sesione informuese në të cilat janë të ftuara organizata të shoqërisë civile, individë dhe grupe informale dhe të gjitha kategoritë e përmendura në fillim të udhëzuesit. Sesionet synojnë të informojnë dhe të rrisin njohuritë e aplikantëve që janë të interesuar për të aplikuar. Në sesionet informuese do të diskutohet mbi tematikat e drejtimeve dhe procedurat e thirrjes dhe do t’i jepet përgjigje të gjitha pyetjeve që kanë të interesuarit mbi Thirrjen për Aplikime. Sesionet informuese do të zhvillohen si më poshtë:

26 Maj, 2021 – Roskovec	ora 11.00 deri në 13:00
27 Maj, 2021 - Vau Dejës	ora 11.00 deri në 13:00
7 Qershor, 2021 - Burrel	ora 11.00 deri në 13:00
09 Qershor, 2021 - Pogradec	ora 11.00 deri në 13:00
11 Qershor, 2021 - Tepelenë	ora 11.00 deri në 13:00
14 Qershor, 2021 - Shijak	ora 11.00 deri në 13:00

Gjithashtu, për të siguruar një informacion sa më të gjerë për aplikantët e interesuar, LevizAlbania gjatë periudhës së Thirrjes Nr. 8 do të përfshijë në websiten e projektit link një seksion të dedikuar për Pyetje/ Përgjigje të Shpeshta.



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

- **Vlerësimi i konceptideve**

Vlerësimi i konceptideve bëhet me pikë për secilin kriter. Nga ky vlerësim do të përzgjidhen aplikantët më cilësorë, të cilët do të ftohen të marrin pjesë në Konkursin e Ideve. Aplikantët të cilët nuk do të mund të vazhdojnë më tej procesin e konkurrimit, do të njoftohen me shkrim për vendimin dhe vlerësimin me pikë.

- **Konkursin e Ideve**

Aplikantët e përzgjedhur do të ftohen të prezantojnë koncept-idenë e tyre gjatë Konkursit të Ideve. Konkursin e Ideve zhvillohen si rregull në tre qytete të ndryshme, megjithatë në varësi të situatës në vend, LevizAlbania vendos zhvillimin e Konkursit të Ideve përmes platformave të teknologjisë së informacionit.

Bordi i Granteve i përbërë nga përfaqësues dhe ekspertë të njohur të shoqërisë civile, qeverisjes vendore dhe medias nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, do të përzgjedhë idetë më cilësore që do të kalojnë në fazën e fundit, atë të hartimit të projektpropozimeve të plota.

Konkursin e Ideve janë të hapura për të gjithë aplikantët dhe të interesuarit dhe do të transmetohen drejtpërsëdrejti në kanalet e komunikimit të LevizAlbania.

- **Përgatitja dhe vlerësimi i Projekt Propozimeve të Plota**

Gjatë kësaj faze aplikantët e përzgjedhur gjatë Konkurseve të Ideve do të përgatisin projektin e plotë, duke pasqyruar sugjerimet dhe komentet e bëra nga Bordi i Granteve. Bordi i Granteve do të vlerësojë projekt propozimet e plota dhe do të marrë vendimin për fituesit. Kriteret e vlerësimit të Projekt Propozimeve të plota janë si më poshtë:

- Reflektim i rekomandimeve të Bordit të Grantit gjatë Konkurseve të Ideve;
- Vlerësim i kapaciteteve menaxhuese, financiare dhe ekspertizës së organizatës/grupit informal/individit;
- Përputhja e buxhetit me objektivat dhe aktivitetet e projektit.

Identifikimi i problemit është kyç për suksesin e një aplikimi. Seksioni që shtjellon identifikimin e problemit do të shqyrtohet me kujdes në të gjitha hapat e procesit të vlerësimit dhe në rast se një koncept-ide nuk paraqet një formulim dhe analizë të qartë të problemit dhe/ose Bordi i Granteve nuk është i kënaqur me shpjegimet e aplikuesit gjatë Konkursit të Ideve, atëherë aplikimi nuk mund të konsiderohet si një ide e vlefshme.



**LEVIZAlbania**  
Demokracia Vendore në Veprim



#RUAJDISTANCËN #VENDOSMASKËN

Nga aplikanti do të kërkohet që të paraqitet në mënyrë të qartë ndërlidhja mes identifikimit të problemit në fazën e parë të koncept-idesë dhe analizës së bërë në projektpropozimin e plotë. Kjo ndërlidhje do të jetë objekt vlerësimi nga Bordi i Granteve gjatë Konkursit të Ideve.

Gjatë fazes së përgatitjes së projektpropozimeve të plota, LevizAlbania do të zhvillojë sesione orientimi për aplikantët e kualifikuar, lidhur me kërkesat që duhet të plotësojnë për paraqitjen e projektpropozimit të plotë. Gjithashtu LevizAlbania do të organizojë, gjatë kësaj faze, disa workshope tematike, referuar instrumentave institucional që janë në dispozicion të aktorëve të shoqërisë civile dhe qytetarëve për të nxitur ndërveprimin e tyre me qeverisjen vendore. Workshopet e planifikuara përfshijnë të drejtën e informimit, masat kundër diskriminimit, angazhimin rinor, etj.

## **8. E Drejta e Ankimimit**

Aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së një ankese, e cila duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dërgimit të informacionit me shkrim nga LevizAlbania. Ankesa duhet të dërgohet me shkrim (email ose postë) nga vetë aplikanti dhe të përshkruajë qartë argumentet për ankimimin. Përgjigja i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimimit.